



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivuty	08.06.23	viti god year	
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shitjca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SRBISHICK	4633/2023		1/6



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.777/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Vjollca Sinani-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2559/2021 të datës 25.05.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.777/2021 të datës 30.08.2021 e parashtruar nga ankuesi me adresë Rr. kundër Vendimit KA.Nr.38/2021 të datës 23.08.2021 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.777/2021 e datës 30.08.2021 e parashtruar nga ankuesi

Mbetet në fuqi Vendimi KA.Nr.38/2021 i datës 23.08.2021 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 20.05.2021 ka shpallur konkursin me Nr. 03/2021 për pozitën Zyrtar Ligjor 1-dy pozita për Gjykatën Themelore në Ferizaj, në të cilin ka aplikuar edhe ankuesi, i cili është përfshirë në listën e shkurtër dhe në fazën e testimit me shkrim. Testi me shkrim për këtë pozitë është mbajtur me datë 30.07.2021, ndërsa pas vlerësimit të testit

me shkrim i njëjti ka marr gjithsej 49.5 pikë, ndërsa ankuesi , më datë 11.08.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 23.08.2021 ka nxjerr Vendim KA.Nr.38/2021 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi listën e kandidatëve të testit me shkrim.

Ankuesi, përmes postës më datë 26.08.2021 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila më datë 30.08.2021 është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.777/2021 me numër protokoll 4438/20212, kundër Vendimit KA.Nr.38/2021 të datës 23.08.2021 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, 03.09.2021 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Sekretariatit i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 21.09.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoll 4438/2021 të datës 30.08.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 11.08.2021 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin e Ankesave; Vendimin KA.Nr.38/2021 të datës 23.08.2021 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Zarin e datës 26.08.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 03.09.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 21.09.2021; Njoftimi për përzgjedhjen përfundimtare i datës 20.08.2021; propozimin për emërimin e kandidatit të rekomanduar i datës 20.08.2021; Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 19.08.2021; Formulari i renditjes përfundimtare të kandidatëve; Përcaktimi i kriterëve për testim me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Deklaratën për mos ekzistimin e konfliktit të interesit; Vendimin me numër reference DS-361/2021 i datës 22.07.2021 për emërimin e Komisionit Përzgjedhës; Konkursin me Nr. 03/2021 i datës 20.05.2021 i shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës; Kërkesën për punësim të kandidat e datës 26.05.2021, Referencën e datës 24.05.2021, Dokument identifikimi, Kontratë për punë dhe detyra specifike e datës 15.03.2021, Certifikatën e datës 31.03.2020, Reference e datës 26.11.2020; Diplomën me Nr. 1521/18 e datës 27.09.2018, Testin me shkrim të datës 30.07.2021 për kandidatin      Formularët e vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë për kandidatin      Kërkesën për punësim e kandidates      e datës 01.06.2021, Certifikatën për periudhën 01.02.2020 deri 31.01.2021, Diplomën me Nr. 5166 e datës 08.11.2017, Certifikatën e datës 10.04.2019, Referencën e datës 13.01.2021, Referencën e datës 26.04.2019, Vërtetimin e datës 27.01.2021, Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj Dega Kaçanik e datës 31.03.2021, Dokument identifikimi, Formularët e vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë për kandidaten      Testin me shkrim i datës 30.07.2021 për kandidaten      Kërkesën për punësim të ankuesit e datës 26.05.2021, Testin me shkrim të datës 30.07.2021

për ankuesin, Diplomën me Nr. 3087 e datës 20.03.2015, Certifikatën e datës 01.04.2016, 01.06.2017, Rekomandimin nga Prokurori i Shtetit, Referencë e datës 11.05.2017; Raport për lëndët e kryerës gjatë vitit 2016/17 i datës 06.05.2017, Dokument identifikimi i ankuesit; Certifikatën e datës 13.05.2019, Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj e datës 25.05.2021, Letër motivimi nga ankuesi, CV-në e ankuesit; Njoftimin e datë 13.10.2021 për ankuesin nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.2559/2021 i datës 25.05.2023 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, *sepse*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.Nr.38/2021 të datës 23.08.2021 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, pretendon që nuk është bërë publikimi i pikëve të testit me shkrim, nuk është bërë vlerësimi i drejtë i testit me shkrim dhe nuk më ka dhënë mundësia të ballafaqohem me komisionin vlerësues, kështu që procesi është i kundërligjshëm në kuptim të nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në bazë të konkursit me Nr. 03/2021 për pozitën *Zyrtar Ligjor 1-dy pozita* për Gjykatën Themelore në Ferizaj të shpallur më datë 20.05.2021 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës, , kriteret kanë qenë të përcaktuar *"Diplomë universitare, Fakulteti Juridik dhe Një vit përvojë pune profesionale"*.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit i cili pretendon se nuk janë publikuar pikët e testit me shkrim, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi në ankesën e datës 11.08.2021 të parashtruar në Komisionin për Ankesa të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të vetmin pretendim e ka pasur që Komisionit të rishqyrtoj testin me shkrim, ndërsa nuk ka pasur ndonjë pretendim tjetër, kështu që as Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk mund ta shqyrtoj një pretendim të tillë për shkak që ndaj këtij pretendimi nuk janë shtjerr burimet e brendshme të ankesave sipas legjislacionit përkatës të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ngase sipas Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative është përcaktuar se cila është forma dhe përmbajtja e kërkesës, respektivisht sipas nenit 77 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar se: *"Dispozitat e këtij Ligji mbi formën, përmbajtjen dhe parashtrimin e kërkesës fillestare, do të zbatohen, përshtatshëmrisht, për çdo aplikim, peticion, propozim, ankesë, kundërshtim, deklaratë apo çdo lloj tjetër parashtrëse, që palët i drejtojnë një organi publik"*, rrjedhimisht çdo dispozitë lidhur me parashtrimin, formën dhe përmbajtjen e kërkesës vlen edhe për rastet e parashtrimit të ankesës, kështu që forma dhe përmbajtja e kërkesës është përcaktua me nenin 73 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"2. Përveçse kur ligji parashikon një përmbajtje të caktuar, kërkesa duhet të jetë njaftueshëm e qartë për t'i mundësuar organit publik të cilit i drejtohet, identifikimin e kërkuarit, pretendimeve dhe qëllimin e saj"*, si rezultat i kësaj ankuesi në

ankesën e datës 11.08.2021 të parashtruar në Komisionin për Ankesa të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nuk ka paraqitur pretendimet përkitazi me publikimin e rezultateve të testit me shkrim.

Kolegji i Këshillit lidhur me shqyrtimin e pretendimit ankimor të ankuesit se vlerësimi i testit me shkrim ka qenë i padrejtë, konstaton se e testi me shkrim ka qenë i përgatitur në frymën e nenit 36 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ndërsa mënyra e vlerësimit të tij është përcaktuar me nenin 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të kësaj rregulloreje, kështu që gjatë shqyrtimit të vlerësimit të testit me shkrim, konstatohet që në këtë pjesë nuk ka diskriminim në raport me vlerësimin e përgjigjeve të ankuesit dhe në raport me kandidatët e përzgjedhur dhe mbi këtë konstatim, Kolegji vlerëson se testi me shkrim i ankuesit është vlerësuar në pajtim me dispozitat e cekura si më lartë, kështu që pretendimet e ankuesit janë të pabazuara, ngase nuk janë shkelur parimet e themelore të shërbimit civil të përcaktuar me nenin 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Meqenëse ankuesit në testin me shkrim ka marr gjithsej 49.5 pikë, për shkak se nuk ka arritur të marr 50% të maksimumit të pikëve të përcaktuar, rrjedhimisht edhe nuk ka mund të dhe kanë qenë të pamjaftueshme për të kaluar në fazën e testit me gojë, ngase për të kaluar në fazën e testimit me gojë kandidatët duhet të kalojnë të paktën 50% të maksimumit të pikëve siç parashihet me nenin 36 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Kandidatët të vilet kalojnë me sukses testimin me shkrim ose arrijnë të mbledhin së paku 50% të maksimumit të pikëve të përcaktuara nga KPSHC pranohen të hyjnë në testimin me gojë. Kandidatët , të cilët nuk kalojnë testimin me shkrim përjashtohen nga fazat e tjera të konkurrimit për pozitën përkatëse të Shërbimit Civil"*, ndërsa testimi me gojë mbahet vetëm për kandidatët , të cilët e kanë kaluar testimin me shkrim siç parashihet me nenin 32 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.

Sa i përket pretendimit të ankuesit se është shkelur neni 11 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi posedon Diplomën me Nr. 3087 të datës 20.03.2015 ku ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, posedon Certifikatën e datës 01.04.2016 me të cilën dëshmohet se ka kryes stazhin e praktikës nga data 01.10.2015 deri më datë 31.03.2016, Certifikatën e datës 01.06.2017 me të cilën dëshmohet se ka kryet stazhin e praktikës nga data 01.06.2016 deri më datës 31.05.2017. Po ashtu edhe kandidatët e përzgjedhur kanë plotësuar kushtet e konkursit ngase kandidati i përzgjedhur posedon Diplomën me Nr. 1521/18 të datës 27.09.2018 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore në Kolegjin AAB në programin Juridik, posedon Certifikatën Nr.91/2020 të datës 31.03.2020 të Gjykatës Themelore në Ferizaj për kryerjen e praktikës gjyqësore nga data 01.04.2019 deri më date 31.03.2020, posedon Kontratës për punë dhe detyra specifike me Nr. 03-38/21 përmes të cilët dëshmohet se ka qenë në marrëdhënie punë nga data 15.03.2021 deri më datë 15.06.2021 në Komunën e Ferizajt. Kandidatja e përzgjedhur posedon Diplomën me Nr.5166 të datës 08.11.2017 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, posedon Certifikatën Nr.138/2019 të datës 10.04.2019 të lëshuar nga Gjykata

Themelore në Ferizaj për kryerjen e praktikës gjyqësore prej datës 01.04.2018 deri më datë 31.03.2019, kështu që Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka gjetur se nga vlerësimi i dokumentacionit të aplikimit rrjedhë se edhe ankuesi edhe kandidatët e përzgjedhur kanë plotësuar kushtet e arsimit dhe përvojës së punës të kërkuar me konkurs, dhe se mbi këtë bazë Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në mënyrë të drejtë ka vlerësuar aplikacionet e ankuesit dhe kandidatëve të përzgjedhur, duke vepruar në pajtim me 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"1.Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve në vijmë:1.1 Arsiminin dhe kualifikimi profesional; si dhe 1.2. përvoja e punës"*.

Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse ankuesi nuk ka vazhduar me fazën e testimit me gojë për shkak që nuk ka kaluar fazën e testimit me shkrim, atëherë faza e testimit me gojë ka vazhduar vetëm për kandidatët që kanë kaluar testin me shkrim dhe nga shqyrtimi i formularit të renditjes përfundimtare të kandidatëve rrjedhë se dy kandidatët e përzgjedhur dhe kanë marr numrin më të madh të pikëve me 389.5 respektivisht 380.25, mbi këtë bazë Kolegji, konstaton se në bazë të dispozitave të nenit 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, parashihet se: *Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë"*.

Nisur nga konstatimet si më sipër, Kolegji vlerëson se procedura e rekrutimit për pozitën e lartcekur është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafi 9 dhe nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës, si dhe dispozita e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.*

Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KA.nr.38/2021 të datës 23.08.2021 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, kështu që të gjitha pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.777/2021, datë 08/06/2023

**Vjollca SINANI**

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së